

Porosia e
EBU DHERR EL GAFFARI

RadijAllahu Anhu

POROSIA E EBU DHERR EL GAFFARI

RadijAllahu anhu

Transmeton Ebu Dherr el-Giffari (RadijAll-llahu anhu) i cili thote: “Me ka urdheruar miku im i dashur (Sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem) me Shtatë gjera:

1. Më ka urëdhrua që t'i dua varfnjakët dhe të jam i afërt me ta.
 2. Me ka urdheruar që të shikoj në atë që është më poshtë se unë (në aspekte materiale),
 3. Më ka urëdhrua që mos shikojë në atë që është në pozite më të larta se unë.
 4. Me ka urdheruar që t'i mbaje lidhjet farefisnore edhe nëse ata më kthejnë shpinën.
 5. Me ka urdheruar që të them të verteten edhe nëse është e hidhur.
 6. Më ka urdhërua që të mos i lyp kërkujt asëgjë.
 7. Me ka urdheruar që të shpresojë në këto fjale. La havle ve la kuvvete il-la bil-lah, sepse ato fjale janë thesar në der Arsh.”
(Hadithi është hasen.)
-

POROSIA E PARE:

“ Me ka urdheruar qe t’i dua varfanjaket dhe te jem i afert me ta...”

Ebu Dherri RadijAll-Ilahu anhu, e zbatonte kete dhe jetonte me varfanjaket, u afrua prane tyre, ulej me ta dhe tregohej modest prane tyre mu ashtu sic e porositi ate i Derguari i All-Ilahut (Sal-laAll-Ilahu alejhi ve sel-lem). Me kete porosi

Me kete porosi edhe All-Ilahu Subhanehu we te A'la. e porositi te Derguarin e Tij (Sal-laAll-Ilahu alejhi ve sel-lem) ne Kur'an, dhe i tha:“
Dhe bere te durueshme veten tende me ata qe e therrasin Zotin e tyre ne mengjes dhe mbremje duke e deshiruar Fytyren e Tij , dhe mos i hiq syte e tu prej prej atyre e te deshirosh bukurine e kesaj bote , e as mos iu bind atij qe ia kemi shmangur zemren e tij prej perkujtimit ndaj Nesh dhe i eshte dhene epshit te vet , e puna e tij eshte ne hmubje dhe teprim.”

(Kehf 18 , 28)

Domethene: behu me te tillet, me te dobetit , nevojtares dhe durimtares te cilet e therrasin Zotin e tyre mengjes e mbremje duke deshiruar Fytyren e Zotit te tyre.

Mos e lako shikimin tend kah dikush pervec tyre prej pronareve te pasurise dhe pozitive te cilet i ka mashtruar jeta e kesaj bote dhe punet e tyre jane ne humnere.

kurse Muhammedi (Sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem) ka thene:

“Vertete All-llahu e ndihmon kete Ummet me te dobetit e tij, me lutjen e tyre, namazin e tyre dhe singëritetin e tyre.” Hadithi eshte sahih.

Gjithashtu ka thene: “Me deshironi dhe me kerkoni me te dobetit, ngase ju me te vertete ndihmoheni dhe iu vie furnizimi me te dobetit e juaj.” (Hadith kudsij)

POROSIA E DYTE:

“... ..me ka urdheruar qe te shikoj ne ate qe eshte me poshte se une (ne aspekte materiale), e te mos shikoj ne ate qe eshte ne pozite me te larte se une...”

Ebu Hurejreja RadijAllahu anhu thot se Muhammedi (Sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem) ka thene:

“Shikoni ne ate qe eshte me poshte se ju e mos shikoni ne ate qe eshte mbi ju, ngase kjo eshte me e afert qe te mos i perbuzni begatite e All-llahut qe ua ka dhene.” Buhariu dhe Muslimi.

POROSIA E TRETE:

“...me ka urdheruar qe t’i mbaje lidhjet farefisnore edhe nese ata ma kthejne shpinen...”

Ebu Hurejreja RadijAllahu anhu thot se Erdhi nje njeri tek i Derguari i All-llahut (Sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem) dhe e pyeti: “ **O i Derguar i All-llahut, une kame farefis me te cilet i mbaje lidhjet kurse ata me shkepusin, u bej mire e ata me bejne keq, jam i bute me ta, kurse ata me shqetesojne dhe jane te ashper me mua. I Derguari (Sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem) i tha:**

“Nese vertete eshte ashtu sic thua, atehere eshte sikur ti t’u fryesh shkrumb dhe hi te zjarre dhe vazhdimisht me ty eshte nje ndihmes nga All-llahu kunder tyre derisa te vazhdodh keshtu.” Muslimi ne Sahihun.

Kurse nga Esmaja (RadijAll-llahu anha), e bija e Ebu Bekr Sidikut (RadijAll-llahu anhu) transmetohet te kete thene:

“Erdhi tek une nena ime duke gene idhujtare ne kohen e te Derguarit (Sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem) dhe kerkova prej tij fetva e i thashe: ‘Ka ardhur tek une nena ime te me kerkoje dicka kurse ajo eshte me idhujtarine e saj, a ti jap dhe t’i mbaj lidhjet me te?’ , e ai me tha: ‘Po, mbaji lidhjet me te.’ ” Buhariu dhe Muslimi

Ebu Hurejreja RadijAllahu anhu thot se Muhammedi (Sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem) ka thene:

“Ai qe i beson All-llahut dhe dites se fundit le t’i mbaje lidhjet farefisnore.” Buhariu dhe Muslimi.

Gjithashtu ka thene: nga Enesi RadijAllahu anhu thot se Muhammedi (Sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem) ka thene:

“Ai i cili deshiron t’i shtohet rizku dhe t’i zgjatet jeta le t’i mbaje lidhjet farefisnore.” Buhariu dhe Muslimi

Abdullah Ibn Amr Ibn As RadijAllahu anhu thot se Muhammedi (Sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem) ka thene:

“Nuk eshte mbajttesi i lidhjeve shperblyesi, por mbajtes i lidhjeve eshte ai i cili kur farefisi i tij e nderprejne, ai i vazhdon lidhjet.”
Buhariu dhe Muslimi.

Abdullah Ibn Omeri RadijAllahu anhu thot se Muhammedi (Sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem) ka thene:

“Lemosha dhene varfanjakut eshte sadaka, ndersa sadakaja dhene ndonje te afermi eshte dy here sadaka: mbajtje lidhjesh dhe sadaka.”
Tirmidhiu.

Xhubejr Ibn Mat'am RadijAllahu anhu thot se Muhammedi (Sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem) ka thene:

“Nuk hyn ne xhennet shkeputesi.”d.m.th. shkeputesi i lidhjeve".
Buhariu dhe Muslimi.

POROSIA E KATERT:

“... me ka urdheruar qe te mos i lyp askujt asgje...”

Thote All-llahu Subhanehu we te A'la.

“ Ai i cili i frikesohet All-llahut , atij Ai i gjen rrugedalje dhe e furnizon ate prej kah as nuk e llogarite , e ai i cili All-llahut i mbeshtetet , atij Ai i mjafton .” Et-Talak 2-3.

Pra, ai qe mbeshtetet ne All-llahun, atij Ai i mjafton dhe e pavareson nga poshterimi i lypjes.

Thote All-llahu Subhanehu we te A'la.

“ Nese all-llahu te sprovon me ndonje te keqe , askush s'mund ta largoje ate pos Tij , po nese te preke me ndonje te mire , s'ka kush qe mund ta pengoje dhuntine e Tij , e me ate te mire e godet kend te doje prej roberve te Tij.” Junus , 107

Abdullah Ibn Abbasit RadijAllahu anhu thot se Muhammedi (Sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem) ka thene:

“Kur te kerkosh, kerko vetem prej All-llahut, dhe kur te kerkosh ndihme, kerko ndihme vetem prej All-llahut.” Ahmedi, Ebu Davudi dhe Ibn Maxhe, ndersa hadithi eshte sahih.

Transmeton Thevbani RadijAllahu anhu thot se Muhammedi (Sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem) ka thene:

“Kush ma garanton mua nje gje, une po i’a garantoj atij Xhennetin?” Thashe: ‘Une’, e ai tha: “Mos kerko prej njerezve asgje.” Keshtu qe ndodhte qe Thevbanit (RadijAll-llahu anhu) t’i binte kamxhiku duke qene i hipur ne kafshe e nuk i thonte askujt: Ma jep, derisa te zbritte dhe ta merrte vet.’ Ahmedi, Ebu Davudi dhe Ibn Maxhe.

Thote poeti:

Ti, bijve te Ademit mos u kerko
Kerkoi Atij, dyert e te Cilit te mbyllur nuk i ka
All-llahu hidherohet nese Atij nuk i kerkon

POROSIA E PESTE:

‘... me ka urdheruar qe ta them te verteten edhe nese eshte e hidhur...’

Per muslimanin eshte e domosdoshme qe ta thote te verteten, porse kur ate ta thuash, patjeter lypset urtesi, e sidomos per ata qe ftojne kah All-llahu Subhanehu we te A'la.

Thote All-llahu Subhanehu we te A'la.

“ Thirr ne rrugen e Zotit tend me urtesi dhe me keshille te bukur, dhe polemizoi ata me ate qe eshte me e mira.” En-Nahl, 125.

Nuk u lejohet thirresve qe te therrasin me vrazhdesi dhe ashpersi. All-llahu i Lartesuari i ka thene te Derguarit te Tij, Sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem :

“ Nga meshira qe ty All-llahu ta dhuroi , ti ishe i bute ndaj tyre , e sikur te ishe i vrazhde e zemer- ashper , ata do te shkaperderdheshin prej teje.” Ali Imran, 159.

Prandaj, thirrja ne rrugen e All-llahut te Lartesar kerkon durim dhe butesi me njerezit derisa te gjesh veshe qe degjojne, perndryshe kurre nuk do te te pranojne.

POROSIA E GJASHTË:

“...me ka urdheruar që të mos i frikësohem për All-llahun qortimit të qortuesve...”

Kur besimtari ta thotë të vertetën, të urdherojë në të mirë dhe të ndalojë nga e keqja, doemos do të sprovohet në fenë e tij,

Thotë All-llahu Subhanehu we te A'la.

“ Urdhero për punë të mira , ndalo nga të keqja dhe përballo me durim atë që të godet.” Lukman, 17.

Githë ashtu Thotë All-llahu Subhanehu we te A'la.

‘ Neve na mjafton All-llahu , e sa mbrojtës i mirë që është Ai.”

Ali Imran, 173

Githë ashtu Thotë All-llahu Subhanehu we te A'la.

“ O ju që keni besuar , kush largohet prej jush nga feja e tij , All-llahu do ta sjell një popull që Ai e do atë, dhe ata e duan Atë, janë modeste e të bute ndaj besimtareve El-Maide, 54

POROSIA E SHTATE:

“... dhe me ka urdheruar qe te shpeshtoj fjalen: La havle ve la kuvvete il-la bil-lah, sepse keto fjale jane thesar nder Arsh.”

Muhammedi (Sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem) u ka thene shume prej shokeve te tij: **Shpeshtonie fjalen La havle ve la kuvvete il-la bil-lah , ngase ato jane prej thesareve te Arshit.**

Te shpeshtuarit e fjales: **La havle ve la kuvvete il-la bil-lah** ka ndikim te cuditshem ne largimin e merzive dhe durim ndaj veshtiresive, ajo e largon deshprimin dhe friken nga zemrat, e ne vend te tyre sjell qetesine dhe rehatine te cilat shtohen aq sa besimtari t’i shpeshtoje keto fjale te cilat jane thesar nder Arsh.

O All-llah, na jep shpirtrave tane devotshmerine e tyre dhe pastroi ata, vertete Ti je qe me se miri i pastron, Ti je Zoti dhe Kujdestari i tyre.
Amin !!!

Dhe lutja jon e fundit është: I tërë falenderimi i takon Allahut, Zotit të botrave.

